

GJON BERISHA**MARRËDHËNIET E GJERGJIT II STRAZIMIR BALSHËS
ME REPUBLIKËN E RAGUZËS**

Një element kyç në historinë e marrëdhënieve të familjes shqiptare Balsha në përgjithësi, dhe në veçanti të Gjergj II Strazimit me Republikën tregtare të Raguzës që nga fundi i shek.XIV dhe fillimi i shek.XV ishte elementi tregtar – doganat dhe sigurimi i veprimtarisë tregtare. Në bregdetin dalmat të Detit Adriatik, Ragusa, që sot është qyteti i Dubrovnikut, ishte vendi më i rëndësishëm fqinj i zotërimeve të Balshajve, me të cilët interesat e bashkëpunimit ishin qenësore dhe të dyanshme. Në anën tjetër, Principata e Balshajve, për Republikën e Raguzës përfaqësonte zonën më të afërt të aktiviteteve, interesat e saj më të rëndësishme tregtare si dhe mundësi e zgjerimit të veprimtarisë tregtare në brigjet shqiptare. Qëllimi ynë në këtë studim është të prezantojmë rolin përcaktues të tregtisë në ndërtimin e raporteve diplomatike në rajon, duke u përqendruar në veçanti në rolin e saj në ruajtjen e komunikimit ndërmjet Gjergjit II Strazimir Balshës dhe Raguzës në periudhën kohore që kur erdhi në pushtet në vitin 1385, deri në vdekjen e tij në vitin 1403.

Për më pak se gjysmë viti pas ardhjes në pushtet në krye të principatës, në të mirë të këtyre raporteve, Gjergji II, lëshoi një diplomë në favor të raguzanëve, përmes së cilës u konfirmuan miqësitë dhe liritë tregtare. Struktura e tregtisë nuk është qëllimi i këtij punimi, prandaj nuk do të jetë objekt i diskutimit tonë. Për këtë mendojmë se duhet një studim i veçantë.

Ngjarjet politike në Adriatikon Jugor të zhvilluara nga fundi i shek.XIV dhe fillimi i shek.XV, kontekstualizojnë marrëdhëniet historike midis Balshajve dhe Raguzës. Me disa luhatje të vogla, këto marrëdhënie, gjithnjë nën ndikimin e interesave tregtare, u karakterizuan si mjaft të mira, siç dëshmohet edhe nga dokumentet e shumta.

Të dhënat e historiografisë mbi marrëdhëniet politike midis Principatës së Balshajve, përkatësisht familjes shqiptare Balsha dhe Raguzës në periudhën e dhënë nuk janë trajtuar sa duhet në studime të

veçanta, kurse sa i përket burimeve të botuara¹ apo atyre të pabotuara nga Arkivat Shtetërore në Dubrovnik (*Reformationes, Lettere e commissioni di Levante dhe Diversa Cancellariae*), këto të dhënat janë të shumta.² Deri më tani janë botuar disa vepra sintetike dhe artikuj të cilat kanë trajtuar vetëm disa nga çështjet e përgjithshme të orientuara më shumë në marrëdhëniet ekonomike të familjes Balsha,³ por jo në mënyrë të detajuar ato të Gjergjit II Strazimirit dhe qytetit të Raguzës. Në përgjithësi, në historiografinë shqiptare, vend të veçantë kanë zënë marrëdhëniet e Shqipërisë mesjetare dhe princërve Balsha me Republikën e Venedikut.⁴

¹ Të botuara: Mihailo J. Dinić, *Odluke veća Dubrovačke republike II*, Beograd: SANU, 1964; Nella Lonza & Zdravko Šundrica, *Odluke dubrovačkih vijeća 1390-1392*, Zagreb-Dubrovnik: 2005; Nella Lonza, *Odluke dubrovačkih vijeća 1395-1397*, Zagreb-Dubrovnik: HAZU 2011; *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, vëll.II (shek.VIII-XV), përgatitur nga A. Buda, I. Zamputi, K. Frashëri, P. Pepo, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1962.

² Të pabotuara, në: *Hrvatska-Državni arhiv u Dubrovniku* (më tej: HR-DADU), *Reformationes*, vol. XXIV-XXXI; HR-DADU, *Lettere e commissioni di Levante*, vol.I-IV; HR-DADU, *Diversa Cancellariae*, vol. XXVI-XXXIV; dhe *diplomat e Balshajve* në: HR-DADU, Fondi i Vjenës (*fondi Beč*).

³ Nga veprat më themelore mbi historinë e familjes së madhe të princërve arbërorë Balsha, konsiderohet vepra e studiuesit nga Kotorri: Giuseppe Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi: studi storici documentati*, Spalato: Tip. Sociale Spalatina G.Laghi, 1899. Kjo vepër është botuar edhe në gjuhën shqipe para disa viteve me titull: Giuseppe Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, përkthyer nga Laura Leka, Tiranë: SHB “55”, 2009. Studime të tjera që tërthorazi janë marrë me këtë problematikë, veçojmë edhe ato të autorëve serbë dhe kroatë, si: Jorjo Tadić, *Promet putnika u starom Dubrovniku*, Dubrovnik: Turističkog saveza u Dubrovniku, 1939; *Istorija Crne Gore II/2* (red. Ćirković, S., Božić, I., Bogdanović, D. & V. Đurić), Titograd: 1970; Ivan Božić, *Nemirno Pomorje XV veka*, Beograd: Srpska književna zadruga, 1979; Vinko Foretić, *Povijest Dubrovnika do 1808. Deo 1, Od osnutka do 1526*, Zagreb: Nakladni zavod MH, 1980; Dušanka Dinić-Knežević, “Zetski primorski gradovi u svetlu dubrovačkih izvora”, në *Srednjovjekovna istorija Crne Gore kao polje istraživanja: bornik radova sa okruglog stola Istorijeskog Instituta*, vol. 3, Podgorica: Istorijiski Institut Crne Gore, 1999; Marijan Premović, “Trgovački odnosi Zete i Dubrovnika od 1385. do 1403. godine”, në *Acta Histriae* Vol. 26, Issue 3, Koper: 2018, f. 889-890.

⁴ Luan Malltezi, *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas: 1392-1478 (aspekte të jetës së tyre)*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1988; *po ai*, “Shkaqet e luftës së Balshës III kundër Republikës së Venedikut në 20 vjetët e parë të shek.XV”, në *Studime Historike*, nr. 2, Tiranë: 1980; Injac Zamputi, “Autonomia e qyteteve shqiptare të principatës së Balshajve dhe pasojat negative të pushtimit venedikas: fundi i shek.XIV-fillimi i shek.XV”, në *Studime Historike*, nr. 3, Tiranë: 1980; si dhe studimi monografik i thelluar i fundit:

Prandaj, ky studim është një përpjekje për të analizuar dhe zgjeruar të dhënat ekzistuese duke u mbështetur në burime të Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut dhe në literaturën relevante.

Në fillim të viteve 70-të të shek.XIV, me shtrirjen që mori, Principata e Balshajve u bë një nga shtetet feudale më të fuqishme në viset shqiptare. Me zotërimin e Ulqinit, Tivarit, vetë Shkodrës, skelës së Shirgjit, dhe me shtënien në dorë përfundimisht të Budvës më 1367, Balshajt filluan të kontrollojnë seriozisht veprimtarinë e tregtarëve të huaj nëpër Adriatik, në mesin e të cilëve edhe të raguzanëve.⁵ Ky fuqizim i Balshajve dhe politika e tyre e jashtme në raport me Venedikun, me Nikollë Altomanoviqin në veri dhe fqinjët e tjerë, tërhoqi me kohë vëmendjen e raguzanëve, të cilët po ndiqnin me kujdes këto zhvillime. Pasi u siguruan se ky fuqizim nuk cenonte interesat e raguzanëve⁶, Raguzë u përpoq t'i përdorë e t'i tërhiqte Balshajt në mbrojtje të interesave të saj tregtare, duke u dhënë më 1361⁷ tre vëllezërve sundimtarë, qytetarinë raguzane. Interesimi i Raguzës për Balshajt u rrit edhe më shumë, veçanërisht kur Nikollë Altomanoviqi u mund nga një aleancë e re që kishte krijuar ndërkohë feudali boshnjak Tvërtko I dhe ai serb Llazar Gërbljanoviqi. Këta arritën të përzënë Nikollën nga tokat e bregdetit dhe të dalin në kufijtë e Raguzës e të Principatës së Balshajve. Në një situatë të tillë Raguzë shpejtoi ta shfrytëzojë miqësinë e Balshajve. Që në vitin 1373, Gjergj I Balsha, i cili kishte mbetur tanimë i pari i familjes, pas vdekjes së Strazimirit (1372) shkoi në Raguzë, ku iu njoh sundimi mbi tre krahina të Dalmacisë: Trebinjë, Konavljë dhe Draçevicë, që shtriheshin në veri të Kotorrit dhe shumë pranë Raguzës.⁸ Gjergji I ua siguroi miqësinë dhe aleancën e vet raguzanëve me një akt

Pranvera Bogdani, *Balshajt: Lufta e principatës së Balshajve dhe sundimtarëve të tjerë shqiptarë kundër Venedikut në 20 vjetët e parë të shekullit XV*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2018.

⁵ P. Bogdani, *Balshajt: Lufta e principatës së Balshajve ...*, f. 48.

⁶ G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi ...*, f. 104.

⁷ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 301.

⁸ Konstantin Jireček, *Die Handelsstrass en und Bergwerke von Serbien und Bosnien während des Mittelalters*, Prag: Verlag, 1879, f. 22-23; *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, college Tholloczy, L.- Jiriček, C. - Sufflay, E., vol.II, Vindobonae MCMXVIII, dok. nr. 372. (Më tej: *Acta Albaniae II*); G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi ...*, f. 99, 105; P. Bogdani, *Balshajt: Lufta e principatës së Balshajve ...*, f. 49.

solemn të nënshkruar në katedralen e Raguzës, *Santa Maria Maggiore*, më 30 nëntor të vitit 1374.⁹ Në diplomën e lëshuar në vitin 1373, Gjergj Balsha I ishte zotuar që t'i ndihmonte dhe t'i mbronte raguzanët me të gjitha mundësitë e veta. Kjo ishte një tregues se deri në ç'masë mund të arrinte ndihma e tij ndaj tyre. Nëse miqësia e tij duhej të mjaftonte për t'i siguruar Raguzës mbrojtje nga çdo sulm apo goditje e Nikollë Altomanoviqit, atëherë armiqhtë e përbashkët, prej të cilëve duhej të ruheshin ishin Venediku, komuna e Kotorrit dhe bani i Bosnjës, Tvërtko I. Përmes kësaj marrëveshjeje, Gjergj Balsha I, e shihte të mundshme shtrirjen e principatës së tij si një veprim koniunktural që nuk nisej jo aq nga interesat ekonomike, të cilat reduktoheshin në një tribut vjetor, por se nga mundësia strategjike për t'i siguruar thellësi mbrojtjes së kufijve veriorë të principatës nga rreziku serbo-boshnjak.¹⁰

Rivaliteti i Raguzës me Venedikun, e cila e kishte sunduar Dalmacinë që nga fillimi i shek.XIII, përfundoi më 1358 me triumfin e ushtrive hungareze. Traktati i paqes me Venedikun u nënshkrua në Zarë, në maj të vitit 1358. Ky traktat bëri një kthesë pozitive në historinë e Republikës së Raguzës. Meqenëse të gjithë qytetet e Dalmacisë kishin njohur kurorën hungareze, Venediku hoqi dorë nga pretendimet e veta për “*të gjithë Dalmacinë nga mesi i Kvarnerit deri në kufijtë e Durrësit*” (“...toti Dalmacie a medietate scilicet Quarnarii usque ad confines Duracii...”). Nga kjo kohë, venedikasit humbën Dalmacinë dhe Raguzën. Ndonëse qytetet dalmate dhe bregdeti ishin pushtuar nga hungarezët, Raguza ishte në gjendje të ruante pavarësinë e saj nën mbrojtjen e Hungarisë. Kjo marrëveshje, e miratoi Raguzën si pjesë e Mbretërisë Hungareze-Kroate. Brenda këtij statusi, Raguza arriti të forcojë pozitën e saj dhe zhvillimin e tregtisë detare. Një tjetër ndryshim i rëndësishëm që rezultoi nga ngjarjet e vitit 1358 ishte në numrin e porteve të qytetit në Raguzë. Sapo pika e fundit e navigimit veneciane u largua nga Raguza, qeveria urdhëroi që katër portet të përfshihen në një të vetëm. Kjo përfundimisht çoi në një emancipim më të madh të statusit të qytetit, i cili nga komunë mesjetare (Komuna e Raguzës) ngadalë u bë republikë sovraane (Republika e Raguzës) dhe ndërtoi në mënyrë të pavarur marrëdhëniet e politikës së jashtme me sundimtarët rajonalë,¹¹ duke

⁹ G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi ...*, f. 105.

¹⁰ P. Bogdani, *Balshajt: Lufta e principatës së Balshajve ...*, f. 50.

¹¹ Bariša Krekić, *Dubrovnik in the 14th and 15th centuries: A City Between East and West*, Oklahoma: University of Oklahoma Press, 1972, f. 39, 72-73; Zdenka

përfshirë në rastin tonë, edhe me Balshajt.¹² Senati nga ana e tij, i përbërë nga tridhjetë deri në dyzet fisnikë të shquar, ishte, pa dyshim, më i rëndësishmi se sa këshillat nga pikëpamja e politikës dhe e marrëdhënieve ndërkombëtare të Raguzës brenda vetë qytetit.

Republika e Shën Vlashit tani u lirua nga kufizimet e venedikasve në lundrimin e saj. Edhe pse kjo nuk solli një ritëm të madh në tregtinë detare raguzane, heqja e barrierave të imponuara nga Venediku pa dyshim hapi mundësi të reja. Një mundësi e tillë erdhi në vitin 1373, kur raguzanët morën nga Papa një leje të kufizuar për tregti me “*jobesimtarët*” në Egjipt dhe Siri.

Marrja e lejes papale, me të gjitha kufizimet, ishte një sukses i konsiderueshëm për tregtarët raguzanë për shkak të pasurisë së tregut të huaj dhe të

vlerës së lartë të mallrave që mund të importoheshin prej andej. Kjo, ishte gjithashtu dëshmi e aftësisë së rritur në masë të madhe të Raguzës për të lundruar në tokat e largëta, një fakt i konfirmuar edhe më tej nga lejet e shumta të marra nga tregtarë individualë raguzanë dhe nga Selia e Shenjtë gjatë viteve 1370-1380 për lundrime në tokat “e pafeve”.¹³

Është e rëndësishme të theksohet koincidenca e kësaj hapeje të re të Raguzës drejt detit me fillimin e problemeve në Gadishullin e Ballkanit. Situata në këtë zonë filloi të ndryshojë shpejt për dy arsye kryesore: vdekjen e papritur të Stefan Dushanit, në vitin 1355 dhe fillimin e depërtimit të turqve osmanë në Evropë. Në këtë kohë, familja Balsha ishte në marrëdhënie të mira me qytetarët e Raguzës, siç edhe dëshmohet nga diplomat e shumta të vëllezërve Balsha: Strazimirit, Gjergjit I dhe Balshës II, më 17 janar dhe 27 qershor të vitit 1368¹⁴; ajo e Gjergjit I Balshës më 30 nëntor 1373¹⁵ dhe 30 maj (konsiderohet të ketë qenë në periudhën 1374-1376)¹⁶, diploma e Balshës II më 20 nëntor 1379¹⁷ dhe

Janeković-Römer, *Višegradski ugovor temelj Dubrovačke Republike*, Zagreb: Golden marketing, 2003, f. 67.

¹² V. Foretić, *Povijest Dubrovnika...*, f. 152-158.

¹³ B. Krekić, *Dubrovnik in the 14th and 15th centuries...*, f. 42-43.

¹⁴ HR-DADU, fondi *Beč*, no.1018; DAD, *Prilozi arhivskim serijama IVa*, 50; DAD, *Diversa Cancellariae*, vëll.XXI, fol.57r.

¹⁵ HR-DADU, fondi *Beč*, no.1022.

¹⁶ Po aty, no.1042.

¹⁷ Po aty, no.1025.

24 prill 1385,¹⁸ diploma e Gjergjit II e datës 27 janar 1386,¹⁹ të lëshuara për qytetin e Shën Vlashit.

Në kohën e fuqizimit dhe të shtrirjes së tij më të madhe, shtetit të Balshajve iu desh të ballafaqohej me sulmet gjithnjë e më të mëdha të pushtuesve osmanë. Në vjeshtën e vitit 1385, një ushtri osmane, nën komandën e Hajredin Pashës, arriti të depëronte në zotërimet jugore të Balshajve dhe iu drejtua Vlorës. Në betejën që u zhvillua në Savër, forcat e Balshës II pësuan humbje, kurse vetë ai ra në fushën e betejës. Nipi i Balshës II, Gjergji II Strazimir Balsha, arriti të shpëtonte nga shteti i dikurshëm, pjesërisht zotërimet e Zetës. Përpjekjet e Gjergjit II, në fillim të sundimit të tij, për të forcuar lidhjet me Republikën e Venedikut ndeshën në ftohtësinë e kësaj të fundit. Për rrjedhojë, princi shqiptar u ofrua me Republikën fqinje të Raguzës.²⁰

Që në fillim të marrjes së pushtetit, Gjergji II Strazimir Balsha, për të forcuar pushtetin dhe për të vazhduar politikën e paraardhësve të tij, si një zotëri i ri dhe i zellshëm iu drejtua Republikës së Raguzës për t'i kërkuar ndihmë financiare në formën e një huaje. Më 5 dhjetor 1385, Raguzë vendosi të mos e miratojë huanë, ndoshta që të mos rrezikonte kapitalet e veta.²¹ Por, meqë bëhej fjalë për të parin gjest në shenjë nderimi dhe për ta bërë refuzimin më të lehtë ndaj zotërisë së ri të Zetës, ata vendosën t'i dërgonin një dhuratë në vlerë prej 500 dukatë. Dhurata në fjalë përbëhej nga një copë pëlhurë e kuqe e nderur, katër copë pëlhura të holla nga Firenze dhe disa copa të tjera pëlhurash të

¹⁸ Po aty, no.1027; Franc Miklosich, *Monumenta Serbica spectantiam historiam Serbice, Bosiae, Regusii*, Vienne: Apud Guilelmum Braumülle, 1858, f. 177, 183-186, 193, 202-203; Stojan Novaković, *Zakonski spomenici srpskih država srednjega veka*, Beograd: Štampano u Državnoj štampariji kraljevine Srbije, 1912, f. 189-190, 192, 196-198; Tadija Smičiklas, *Diplomatički zbornik Kraljevine Hrvatske, Dalmacije i Slavonije*, sv. XIV, *Listine godina 1367-1373, Codex diplomaticus Regni Croatiae, Dalmatiae et Slavoniae*, Zagreb: JAZU, 1916, f. 110, 554; Ljubomir Stojanović, *Stare srpske povelje i pisma*. Knj. I, Dubrovnik i susedi njegovi. Deo 1, Beograd: SKA, 1929, f. 104-107, 109-110; Božidar Šekularac, *Dukljansko-zetske povelje*, Titograd: 1987, f. 159-173.

¹⁹ HR-DADU, fondi *Beč*, no.1028.

²⁰ *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. I, f. 304.

²¹ “*Die V decembris 1385 - Prima pars est de excusando nos ambassiatoribus d. Georgii de Balsa de imprestito pro sui parte postulato. Secunda pars de respondendo per nostros ambassiatores ellectos ad dictum dominum*”, HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXVI (1384-1386), fol.52r; G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi ...*, f.151.

zakonshme. Ata duhej të shkonin bashkë me familjen me një brigantin (*brighintino*) luftime të pajisur mirë.²² Autoritetet e Raguzës, vendosën që këto dhurata të jepeshin me një ceremoni shtetërore, e cila, zakonisht u rezervohej vetëm sundimtarëve me kurorë. Dhuratat si mesazh diplomatik shprehën respekt, besim, dashuri, miqësi dhe paqe.²³ Veshja fiorentinase ishte shumë cilësore dhe e kërkuar në tregun e kohës. Këto pëlhura përputhen me nevojat e zotërisë së Zetës, interesave dhe tendencave të tij. Lloji i dhuratës, vlera e saj dhe mënyra e dorëzimit janë të një rëndësie të madhe për të kuptuar mënyrën joverbale të komunikimit diplomatik të Raguzës, dhe dhurata e tillë është në fakt një simbol kuptimplotë.²⁴ Deri në fund të majit të vitit 1388, Senati i Raguzës vendosi t'i dërgonte sundimtarin boshnjak, Tvërtko I një dhuratë prej pëlhurave (2 pëlhura të ndezura dhe 2 pëlhura të holla nga Firenze).²⁵ Nëse e krahasojmë këtë dhuratë dhe vlerën e pëlhurave dhënë Gjergjit II, shohim se vlera e dhuratës për Tvërtkon ishte shumë më e vogël, gjë që do të thotë se Raguzë, vlerën e dhuratës ishte në gjendje ta përshtaste me interesat dhe vlerën e misionit politik.²⁶

Dhurata duhej të dorëzohej nga përfaqësuesit që do të lehtësonin negociatat dhe do të mundësonin realizimin e qëllimeve të misionit. Ndryshimi i fronit të Zetës kërkonte konfirmimin e akteve të mëparshme. Raguzë kërkonte që sa më shpejt të jetë e mundur të merrte një diplomë

²² “*Die VII mensis decembris 1385 - Prima Pars est de emendo pro dictis VC duc. pro presentando dicto d. Georgio unam pecciam iscarleti de grana fini et ipeccias IIII panni fini de Cumis vel de Florencia et totum residuum de aliis pannis bonis circha duc. XXX pro peccia. [...] Prima pars est quod nostri ambassiatores ituri ad d. Georgium predictum mittantur cum una barcha bona in bandis et cum alia sine bandis. Secunda pars quod mittantur cum brighintino armato cum I remo pro quolibet bancho. Captum per XI.*”, HR-DADU, *Reformationes*, vol. XXVI (1384-1386), fol. 52v; 55r.

²³ Zdravko Šundrica, *Tajna kutija Dubrovačkog arhiva I. dio*, Zagreb-Dubrovnik: HAZU, 2008, f. 143.

²⁴ Dušanka Dinić-Knežević, *Tkanine u privredi srednjovekovnog Dubrovnika*, Beograd: SANU, 1982, f. 63.

²⁵ “*Die XXVII maii 1388 ... de donando d. regi Bosne per nostrum ambassiatores pecias II pani de grana et II de panno fino florentino*”, HR-DADU, *Reformationes*, vol. XXVII (1386-1388), fol. 126v-127r.

²⁶ Valentina Zovko, “Diplomatski ceremonijal – Važan oblik komunikacije u pregovorima oko proširenja dubrovačkih granica”, në *Radovi za povijesne znanosti HAZU u Zadru*, sv. 55, Zadar: 2013, f. 20.

të re, e cila rikonfirmonte dhe të gjitha privilegjet dhe garancitë për tregti të lirë, të fituara më parë nga paraardhësit e Gjergjit II Strazimirit.²⁷

Pas kësaj, më 13 janar 1386 nga porti i Raguzës u nisën ambasadorët Simon Bona (*Symon de Bona*) dhe Gjakomo Gondola (*Jacomo de Gondola*). Delegacioni raguzan qëndroi për një muaj në oborrin e Gjergjit II Strazimir Balshës, kurse në Raguzë u kthyen më 11 shkurt të po atij viti,²⁸ dhe vetëm pasi siguruan të drejtën e lirimit nga taksat: siç ishte lirimi i plotë nga taksat doganore në Danjë, eksportimi i lirë i drithërave kundrejt një takse krejt të parëndësishme si dhe të drejtat që kishin gëzuar deri atëherë. Kohëzgjatja e qëndrimit dhe rezultati i misionit u quajt nga raguzanët si një prej ngjarjeve më fatlume, për të cilën dëshmohet edhe në dokument. Duke u vlerësuar kjo ngjarje, nga zyrtari i Senatit të Raguzës, u regjistrua si lajm i veçantë në faqen e parë të Librit të Këshillit (*Reformationes*), ndonëse libri ishte gati i plotësuar.²⁹

Meqë qëndrimi i delegacionit në oborrin e Balshajve ishte relativisht i gjatë edhe protokollit i diplomatëve raguzanë ishte i precizuar në detaje. Të gjitha detajet diskutoheshin paraprakisht dhe nëse kishte ndonjë ndryshim të rastit, delegatët nuk mund të vepronin sipas gjykimit të tyre, por duhej të kërkonin udhëzime të reja. Gjithsesi, politika e diplomatëve të Republikës së Shën Vlashit, gjatë vizitave të tyre, ishte në shërbim të interesave të tyre tregtare. Dokumentet në dispozicion, nuk na bëjnë të ditur plotësisht përmbajtjen dhe rrjedhën e bisedimeve të sundimtarit të Zetës, Gjergjit II me të dërguarit e Raguzës. Përveç dhuratave, përfaqësuesit raguzanë kishin për detyrë që me bashkëbiseduesin t'i zgjidhnin fjalët që shprehnin dashamirësi. Të dërguarit duhej që, gjatë bisedimeve, të bënin përpjekje për të fituar dhe krijuar një atmosferë të favorshme që do të nxiste negociatat. Ata e dinin mirë se çfarë dhe në çfarë mënyrë ata duhet të shpreheshin në takimin e parë publik. Po ashtu, e kishin detyrim për ta pyetur për shëndetin, vetëm nëse ai ishte i sëmurë. Një nga gjërat më të rëndësishme ishte që gjatë bisedimeve të nxjerrin në

²⁷ HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXVI (1384-1386), fol.55r; G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi ...*, f. 151-152.

²⁸ “*Die 14 Januari Ser Symon de Bona, ser Jacomus de Gondola fuerunt ad D[ominum] Georgii de Balsa et optinuerunt poveglias quas portaverunt cum bullis eiusdem. Redierunt die XI feb[ruarii] eiusdem anni*”, HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXVI (1384-1386), fol.1r; 58r; G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi ...*, f. 152.

²⁹ Cfr.: HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXVI (1384-1386), fol.1r.

pah marrëdhëniet e mira dhe miqësitë me paraardhësit dhe të afërmit e tjerë.³⁰

Nga përshtypjet e thella të ambasadorëve mund të mendohet se edhe atyre iu rezervua një mikpritje madhështore nga zotëria i ri i Zetës. Në diplomën e 27 janarit 1386, Gjergji II, ndryshe nga paraardhësit e tij, të cilët mbanin titullin e thjeshtë *Zotëri i Zetës* e të tjerë si ky, ndonëse nuk e kishte punën mirë me territoret, Gjergji II i vuri vetes një titull më të rëndësishëm dhe më solemn, duke u quajtur “*besimtar i Krishtit dhe zotëri absolut i të gjithë Zetës dhe tokave bregdetare*”. Në Raguzë, ai quhej thjeshtë *zotëri i Ulqinit*, dhe nderimi me ceremoni që iu bë nga ambasadorët e Raguzës, ishte praktikë e protokollit diplomatik që synonte të siguronte të drejtat tregtare, të cilat edhe i morën.³¹

Pra, misioni diplomatik i ambasadorëve raguzanë pranë oborrit të Gjergj II Strazimir Balshës kaloi mirë dhe përfundoi me sukses. Akti kryesor ishte se më 27 janar 1386, në Shkodër, Gjergji II lëshoi një diplomë³² për qytetarët e Raguzës, përmes së cilës konfirmonte miqësinë dhe lirinë e tregtisë së lirë. Nga kjo diplomë, raguzanët kishin përfitime që ishin shumë më të gjera dhe madje edhe më të favorshme se ato të mëparshmet. Këto dhurata nuk ishin të vetmet që iu bënë Gjergjit II, si shenjë e marrëdhënieve të mira në mes tij dhe Raguzës. Pëlhurat ishin një nga produktet e rëndësishme të eksportit të Raguzës. Disa herë në Zetë u dërguan pëlhura të shtrenjta si dhuratë për Gjergjin II Strazimirin. Në Këshillin e Vogël të Raguzës (më 8 korrik 1389)³³, u vendos që Gjergjit II, t’i jepeshin një copë e kuqe e ndezur dhe 2 copë pëlhura të holla. Këshilli i Madh në Dubrovnik vendosi që, më 31 nëntor dhe 1 dhjetor të vitit 1395, t’i dërgojnë zotërisë së Zetës një dhuratë prej pëlhurave të ndryshme, me rastin e martesës së mbesës të tij.³⁴

³⁰ Zdenka Janeković Römer, “O poslaničkoj službi i diplomatskom protokolu Dubrovačke Republike u XV. Stoljeću”, në *Zbornik Diplomatske akademije*, br.4, Zagreb: 1999, f. 196-199.

³¹ G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi ...*, f. 153.

³² HR-DADU, fondi *Beč*, no.1028. Kjo diplomë është botuar disa herë: F. Miklosich, *Monumenta Serbica...*, f. 203-204; S. Novaković, *Zakonski spomenici...*, f. 198-200; Lj. Stojanović, *Stare srpske povelje i pisma...*, f. 110-111; B. Šekularac, *Dukljansko...*, f. 173-177.

³³ Dinić-Knežević, *Tkanine u privredi...*, f. 63.

³⁴ “*Die ultimo octobris. In ultrascripto maiori consilio, ballote ... est de faciendo dona domino Iure Strazimerii pro sponsallibus que est facturus de quadam nepte sua et de mittendo dicto Iure eius filium per brigantinum nostrum minorem*”, “... est de

Diplomat e vitit 1385 dhe 1386 gjithashtu rregulluan çështjen e anijeve të Raguzës që do të dëmtoheshin në territorin e kontrolluar nga Balshajt. Në diplomën e parë, thuhej shkurtimisht se askush nuk duhet të marrë ndonjë gjë ose të shqetësojë në asnjë mënyrë anijet e dëmtuara [prishura] të Raguzës në vendin e tij.³⁵ Ndryshe nga diplomat e mëparshme të Balshajve, në këtë të vitit 1386, ekzistojnë dy dispozita të reja që zgjeronin liritë tregtare të Raguzës. Në të parën parashihej që autoritetet e zotërisë së Zetës nuk do t'u shkaktojë askush asnjë dëm qoftë atyre, qoftë mallrave nga anijet e Raguzës që lundrojnë përgjatë bregut të Zetës, si dhe ofronte garanci për sigurinë e mallrave. Nëse do të ndodhte që dikush t'i merrte apo dëmtonte mallrat, dëmi do të kompensohej nga thesari i Gjergjit II. Dispozita e dytë vlente për tregtinë e kripës.

Një vend jashtëzakonisht të rëndësishëm në tregtinë e Republikës së Shën Vlashit, zinte kripa, produkt thelbësor për ushqimin e popullatës, kafshëve, ruajtjen e mishit, peshkut dhe përpunimin e produkteve të mishit. Si produkt thelbësor, u sillte të ardhura të konsiderueshme qytetarëve të Raguzës. Zeta ishte kryesisht një vend blegtoral por me kripë furnizohej nga kriporet e saj në bregdet. Në territoret nga Neretva në Bunë, tregtia e kripës ishte e koncentruar, kryesisht, në katër tregje (Drijevë, Dubrovnik, Kotorr dhe Shën Shirgj). Raguzanët nuk pajtoheshin me ekzistencën e numrit të madh të tregjeve të kripës, duke ruajtur monopolin mbi këtë produkt. Edhe në këtë dispozitë, Gjergji II, zotohej se u bënte favore për tregun e kripës duke mos lejuar që të shitej në asnjë vend tjetër, përveçse në vendet e përmendura.³⁶ Kështu, “dashuria e vjetër” në mes të qytetarëve të Balshajve dhe atyre të Raguzës e zotuar në diplomën e vitit 1385 nga Balsha II, rikonfirmohej përsëri me diplomën e vitit 1386 nga Gjergji II.

Një pjesë e madhe e tregtisë së Raguzës me Kosovën dhe trevat e tjera më në thellësi, zhvillohej përmes territoreve të zotëruara nga Balshajt. Në këtë drejtim, pikë e rëndësishme në këtë rrugë ka qenë

faciendo dona domino Georgio Strazimerii pro sponsalibus neptis quam modo maritat, videlicet de media peçcia panni de schirlato, de media peccia panni de grana et de duabus fodris martirum vel fuinarum”, HR-DADU, Reformationes, vol.XXX (1395-1397), fol. 116r.

³⁵ HR-DADU, fondi *Beč*, no.1027; S. Novaković, *Zakonski spomenici...*, f. 197-198.

³⁶ HR-DADU, fondi *Beč*, no.1028; S. Novaković, *Zakonski spomenici...*, f. 198; L. Stojanović, *Stare srpske povelje i pisma ...*, f. 63, 95.

dogana në Danjë,³⁷ e vendosur në dalje të Drinit, një kryqëzim rrugësh që shkonte nga Shkodra dhe Lezha, në drejtim të Prizrenit, dhe më tej në Kosovë dhe Shkup. Prandaj, çështja e doganës në Danjë ishte një pikë shumë e rëndësishme në marrëdhëniet mes Balshajve dhe Raguzës. Diploma e 17 janarit 1368 ishte pikërisht për shkak të kësaj dogane që Balshajt e vendosën në Danjë. Nga burime të tjera mund të shihet se Balshajt, përveç detyrimit ekzistues të paguar për mallrat e transportuara me anije, u përpoqën të vendosnin dogana për mallrat që transportoheshin me rrugë tokësore.³⁸

Në diplomën e vitit 1373, Gjergji I, i premtojte raguzanëve se ata nuk do të vendosin detyrime doganore që nuk ekzistonin gjatë kohës së Stefan Dushanit, në këmbim të pagesës së një tributi tradicional vjetor (tributi për Ditën e Shën Dhimitrit) për sa kohë që ai do të zotërojë mbi rajonin bregdetar që gjendet rreth Raguzës.³⁹ Tributi të tillë u jepte Balshajve edhe qyteti i Kotorrit. Edhe në diplomën e 20 nëntorit 1379, Balsha II, përveç të tjerash, rregullonte pagesën e doganave dhe konfirmonte statusin që gëzonin nën vëllanë e tij, Gjergjin I. Në këtë akt përcaktohej që tregtarët e Raguzës mund të eksportojnë drithëra, por njëkohësisht, duhet të paguajnë taksën doganore që ka qenë më parë në shumën prej dy dinarë për thes, dhe “*në Danjë dhe Kriva Rekë të paguajnë aq sa kanë paguar kur ka qenë gjallë vëllai im, zoti Gjergj*”.⁴⁰ Edhe në diplomën e vitit 1385, urdhërohej që tregtarët raguzanë, në Danjë të mos paguajnë asgjë, as doganë, as taksa anijesh, ashtu siç nuk kanë paguar në kohën e Stefan Dushanit dhe Gjergjit I. Ky lirim nga taksa doganore u rikonfirmua edhe në diplomën e vitit 1386, ku Gjergji II urdhëronte “*që në Danjë, as në ndonjë vend tjetër në vendin tim të mos*

³⁷ Tregu i Danjës ishte në qeverisjen e Balshajve deri në fund të vitit 1392, për të kaluar nën sundimin osman nga viti 1393 deri më 1395. Gjergji II Strazimir Balsha arriti ta çlironte Shën Shirgjin nga osmanët, por ai nuk kishte forcën për ta mbajtur dhe e dorëzoi te venedikasit.

³⁸ Në vitin 1377, raguzanët pretendonin se taksat doganore në të kaluarën, paguheshin në Danjë vetëm për mallrat që transportoheshin me anije. “*Primieramente sopra lo fatto delle usance antiche, chi vol saver, il debi dir che al Dangno, quando se parecava cum ladia, se pagava grosso uno per zascuna salma, et quando se trasia senca ladia non se pagava nienti*”, *Istoriya Crne Gore* II/2..., f. 46.

³⁹ HR-DADU, fondi *Beč*, no.1022; S. Novaković, *Zakonski spomenici...*, f. 192.

⁴⁰ HR-DADU, fondi *Beč*, no.1025; S. Novaković, *Zakonski spomenici...*, f. 196.

paguajnë taksën doganore, po të vazhdohet ashtu siç ka qenë në kohën e Dushanit”.⁴¹

Vetë pozicioni gjeografik i shtetit të Balshajve dhe rëndësia e doganës në Danjë, si dhe doganave të tjera, i detyronte autoritetet e Raguzës që të kërkonin në vazhdimësi konfirmimin e privilegjeve që lidheshin me to.

Duket se lirimi nga taksat e doganave ishte rregulluar si veprim i ndërsjellë, ku sipas marrëveshjes zotërinjtë Balsha dhe njerëzit e tyre nuk paguanin dogana në Raguzë. Por, edhe pse marrëdhëniet tregtare dhe diplomatike ishin të mira dhe të suksesshme, megjithatë, në periudha të caktuara kishte edhe luhatje dhe reduktim të këtyre raporteve. Për shkak të konflikteve dhe luftës në këtë zonë, epidemisë së murtajës, vendosjes së doganave të reja dhe sulmeve ndaj tregtarëve të Raguzës, sidomos në vitet 1395, 1396, 1397 dhe 1403, pati ndërprerje të vogla të tregtisë. Në dokumente, fenomeni më i shpeshtë na del të ishin plaçkitjet e tregtarëve dhe mallit të tyre. Më 1386, raguzanët u ankuan te Gjergji II se tregtarët e tij ua morën grurin nga anija e tyre.⁴² Diku para prillit të vitit 1396, përsëri pati një përplasje. Tregtarët e Raguzës ishin të shqetësuar, meqë ishin grabitur nga njerëzit e Gjergjit II. Menjëherë pas kësaj ngjarjeje, kur në Raguzë po shitej gjalpë, që ishte në pronësi të zotërisë së Zetës, lindën keqkuptime në lidhje me disa detyrime doganore. Në letrën e tyre të datës 7 prill 1396, raguzanët mundoheshin të bindnin Gjergjin II se asnjëherë nuk i kishin marrë asnjë taksë atij, ose qytetarëve të tij. Në përgjigje të detyrimeve doganore për gjalpin, njerëzit e Gjergjit, më 12 maj 1396, në emër të doganës, u konfiskuan përsëri mallrat tregtarëve të Raguzës.⁴³ Më 28 nëntor, të po atij viti, Senati i Raguzës e diskutoi këtë rast.⁴⁴ Në shkurt

⁴¹ HR-DADU, fondi *Beč*, no.1028; S. Novaković, *Zakonski spomenici...*, f. 198; L. Stojanović, *Stare srpske povelje i pisma...*, f. 63, 95.

⁴² “*Die ultimo martii...de conquerendo comuni Dulcinii et domino Georgio de ingrato (?) modo servato per Dulcinatos in accipiendo frumentum nostro navigio quod ibi fuit frumento honusto.*”, HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXVI (1384-1386), fol.64r; *Acta Albaniae II*, dok. nr.394

⁴³ Po aty, nr. 554.

⁴⁴ “*In minori consilio more solito congregato captum fuit quod omnes illi qui habuerunt mercancias et res in garavano, cui garavano fuit ablata per vim gabella contra ordines et pacta etc. per dominum Georgium Strazimerii, et de qua gabella facta est querella et eorum propinqui non possint interesse un iudicio determinationibus fiendis super dicta querella*”, HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXX (1395-1397), fol.45r.

të vitit 1397, autoritetet e Raguzës, i kërkuan përsëri Gjergjit II, që të shfuqizonte marrjen e paligjshme të detyrimeve doganore.⁴⁵ Një muaj më vonë, ata përsëri protestuan te zotëria i Zetës lidhur me pagesën e doganës për produktin e vajit.⁴⁶ Mosmarrëveshja u përfundua vetëm në dhjetor të vitit 1398, atëherë tregtarët e Raguzës u lejuan që t'i shesin mallrat e tyre në tregjet e Zetës. Doganat ishin aktive edhe në vitin 1403. Pas vdekjes së Gjergjit II, më 18 prill, përfaqësuesit e Raguzës që shkuan për ngushëllime e shfrytëzuan mundësinë për të kërkuar nga Helena heqjen e doganave të sapokrijuara në Ulqin.⁴⁷

Siç u përmend më lart, një lloj shkaktari tjetër i veçantë në ngecjen e aktiviteteve tregtare dhe marrëdhënieve në mes Balshajve dhe Raguzës, ishte paraqitja e epidemive, veçanërisht e sëmundjes së murtajës. Në kohë të epidemive, mbikëqyrja e të huajve që frekuentonin Republikën e Shën Vlashit u bë më e theksuar. Për të evituar përhapjen murtajës, Republika e Raguzës, disa herë i ndaloi tregtarët e saj që të shkonin në Zetë. Këshilli i Vogël, më 1 prill të vitit 1391 merr vendim të mos lejojë pronarët e anijeve dhe ekuipazhin e tyre, qytetarët, besimtarët dhe e as ndonjë tjetër, të shkojnë në Budva apo Ulqin për shkak të murtajës, e cila thuhej të jetë përhapur në këto vende. Urdhëresa, gjithashtu ndalonte hyrjen në Raguzë, për të gjithë ata që dëshirojnë të vijnë në qytet nga zona e Budvës dhe Ulqinit. Në dokument, po ashtu, thuhej se shkelësit e kësaj urdhërese do të gjobiteshin deri në 100 dukat.⁴⁸

⁴⁵ L. Stojanović, *Stare srpske povelje i pisma ...*, f. 112-114.

⁴⁶ *Acta Albaniae II...*, dok. nr. 584.

⁴⁷ HR-DADU, *Lettere e commissioni di Levante*, vol.IV (1403-1410), fol.12r.

⁴⁸ “*Kalendis aprilis MCCCLXXXI... Ser Nicolao de Mençe, ser Petro de Saracha et ser Marino Martoli de Bucignolo, officialibus ad procedendum et providendum contra venientes de locis pestiferis in minori consilio more solito ad sonum campane congregato, ex auctoritate hodie habita a maiori consilio, datum fuit arbitrium et libera auctoritas vetandi quibuscumque de districtu Ragusii patronis, marinariis barcharum et aliis quibuscumque hominibus et personis, cuiusvis condicionis existant, quod non vadant nec adhere presumant modo aliquo ad loca aliqua vel contratas positas a Budva usque Dulcinium propter pestem que dicitur esse in illis locis et partibus, et similiter vetandi quibuscumque et undecumque sint venientibus de dictis partibus et locis, quod non intrent in Ragusio, et pro dicto eorum officio exercendo ponendi penam et penas quibuscumque eis videbitur pro observatione predictorum a ducatis centum infra pro singulo cui aliquid preceperint occaxione dicti officii et singulla vice.*”, HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXIX (1390-1392), fol.13v; Lonza & Šundrica, *Odluke dubrovačkih vijeća 1390-1392...*, f. 153.

Më 7 qershor 1392, Republika i ndalonte tregtarët që të vinin nga Ulqini dhe vendet e tjera ku ishte përhapur murtaja.⁴⁹ Përsëri, më 11 qershor, Këshilli i Vogël, nxori vendim sipas së cilit, të gjithë ata persona që vijnë nga Ulqini apo vendet e tjera të prekura nga murtaja vdekjeprurëse, duhet të merren në ishullin Malonto (port dhe vendbanim në jug të Cavtatit), me paralajmërimin se ata nuk mund të banojnë në asnjë pjesë të rrethit të Raguzës në distancë prej 1 milje, për të paktën një muaj, përveç në Melita (Mljet).⁵⁰ Në gjysmën e parë të shtatorit të po atij viti, Matheus de Georgio dhe vëllai i tij Nalchus (Nulku), me udhëzimin e Këshillit të qytetit, shkuan në Ulqin, dhe nga atje duhej që të informonin Senatin e qytetit të Shën Vlashit për praninë e sëmundjes së murtajës.⁵¹ Kur ata u kthyen më 26 shtator 1392, informuan se qytetin e Ulqinit, nga sëmundja e murtajës e kishte kapluar vdekja.⁵²

Gjatë viteve 1386 dhe 1388 ushtritë osmane të komanduara nga qefalia Shahin Beu ndërmorën disa fushata ushtarake ndaj Bosnjës. Në këto ekspedita, në anën e osmanëve morën pjesë edhe shtetas të Gjergjit II Strazimirit, si pasojë e armiqësive të shkaktuara me mbretin boshnjak Tvërtko. Lajmi i dhënë në tetor të vitit 1386 për këtë ekspeditë të ushtrive turke, shkaktoi frikë edhe në Raguzë. Këshilli i Madh e udhëzoi Senatin dhe Këshillin e Vogël që të grumbullonte të holla nga debitorët ose të

⁴⁹ “...*Ulcinj et ad alia loca ubi sit pestis...*”, HR-DADU, *Diversa Cancellariae*, vol. XXX (1392-1394.), fol.112r.

⁵⁰ “*Die XI iunii in minori consilio additum fuit quod ubi supra datur terminus XV dierum, quod sit terminus unius mensis standi extra, et quod venientes de Dulcinio vel de aliis locis pestiferis non possint stare a Malonto citra I milliario versus ponentem in aliquo loco per totum districtum Ragusii, includendo etiam Melitam in districtu predicto.*”, HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXIX (1390-1392), fol.29v.

⁵¹ “*Ser Matheo de Georgio in dicto minori consilio facta et data fuit gracia et licencia quod possit ire Dolzignum, ita tamen quod ibidem non vigeat pestis, et quod si intrabit Dolzignum et ibidem esset pestis ... Ser Matheo de Georgio seu ser Nalcho eius fratri facta fuit gracia quod possint ire Dolzignum et ibidem in terram descendere, verum si mortalitas ibi non sit, et si pur vellet descendere in terram et esset mortalitas ibidem, quod possit descendere, sed stet ille qui ex ipsis fratribus iverit per unum mensem extra Ragusium et districtum. Et in eius reversione defferatur sacramento ipsi ser Matheo vel ipsi ser Nalcho, videlicet quis eorum iverit, an pestis fuerit in Dolzigno vel non, et de hoc stetur sacramento illius qui iverit ex ipsis fratribus. Et si non descenderet ibidem in terram, quod possit venire libere in Ragusium.*”, HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXIX (1390-1392), fol.52v.

⁵² “*Die XXVI septembris 1392. Suprascriptus ser Matheus fuit reversus a Dolzigno et se presentavit et iuravit ad sancta Dei evangelia corporaliter, tactis scripturis, quod in ipsa terra Dolzigni hodie non vigeat mortalitas*”. Po aty.

shiste disa mallra të zakonshme me qëllim që të ndalonte kërcënimin osman dhe të dërgonte përfaqësues në të gjitha vendet. Menjëherë, Ragusa dërgoi përfaqësues te Tvërtko dhe Gjergji II. Këshilli i Vogël zgjodhi dy oficerë të posaçëm për t'u kujdesur për armatimin dhe mbrojtjen e qytetit “*provisores pro facto Turchorum*” dhe dy të tjerë për të mbikëqyrur mbrojtjen e qytetit Stagno (Stonit në afërsi të qytetit të Raguzës).⁵³

Autoritetet e Raguzës dëshironin me çdo kusht të shmangnin luftën e armatosur duke përdorur diplomacinë, me qëllim që të eliminonin rrezikun osman, duke negociuar me Gjergjin II. Brenda një kohe të shkurtër, raguzanët mblodhën informata të shumta nga tregtarët dhe të dërguarit e tyre, kështu që ata ishin të bindur se Gjergji II kishte ndikim mbi osmanët, meqë ai, në këtë kohë, ishte në aleancë me ta. Më 10 gusht të vitit 1388, Senati i dërgoi si ambasador nga Ulqini, priftin Marin Buçinjolli (Marino Bucignolo), i cili banonte në Raguzë.⁵⁴ Nga ana e tij, Gjergji II Strazimiri dërgoi si ambasador në Raguzë, Zhanin (Çanino), të birin e Filip Barellit. Mirëpo, ndërsa zhvilloheshin këto bisedime, boshnjakët arritën të thyejnë ushtrinë osmane në afërsi të Trebinjës dhe të zënë robër një numër të konsiderueshëm shqiptarësh, shtetas të Gjergjit II. Këta nuk u shitën si skllëvër në saje të ndërhyrjes së përfaqësuesit të Gjergjit II te raguzanët.⁵⁵ Më 22 gusht 1388, *Zhanin di Filippo Barelli* i këshilloi raguzanët, për të mirën e tyre, që t'i lironin sa më shpejt refugjatët e luftës të ardhur nga Shqipëria.⁵⁶ Me sa duket misioni i

⁵³ M. J. Dinić, *Odluke veća Dubrovačke ...*, II, f. 480; Ivan Božić, *Dubrovnik i Turska u XIV i XV veku*, Beograd: Naučna knjiga, 1952, f. 9.

⁵⁴ “*Prima pars est de mitendo unum nuncium domini Georgio de Balsa pro facto Turchorum... est de mittendo dominum Marinum ad dictum dominum Georgium... est de dando arbitrium consilio minori faciendi commissionem domini Marini et expediendi ambaxiatam...*”, HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXVII (1386-1388), fol.85v.

⁵⁵ G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi ...*, f. 166.

⁵⁶ “*Die XXII augusti. Rogatorum ballota XIII. Prima pars est de presentando Çaninum filium Philippì Bareli, qui venit in ambaxiatorem pro bono et utilitate nostra tractanda super facto Turchorum, usque ad summam ducatorum XX*”, HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXVII (1386-1388), fol.87v; M. J. Dinić, *Odluke veća Dubrovačke ...*, II, f. 440; P. Bogdani, *Balshajt: Lufta e principatës së Balshajve ...*, f. 55. Më gjerësisht për misionin dhe veprimtarinë e Filip Barellit në oborin e Balshajve, shih: Gjon Berisha, “Agjenti dhe tregtari Filip Barelli në oborin e Balshajve: influenza e tij në gjysmën e dytë të shek.XIV”, në *Studime Historike*, nr.1-2, Tiranë: 2018, f.35-54.

Çaninit dha rezultate të mira, meqë më 26 gusht, Raguzë ndikoi që t'i lirojë ata dhe dekretoi ndalimin e shitjes së shqiptarëve si skllavër, në këtë vend apo në rrethin e tij.⁵⁷ Në anën tjetër, edhe misioni i përfaqësuesit raguzan, Marinin dhe ai i përfaqësuesit të Gjergjit II, Çaninit u treguan të suksesshëm, gjë që ishte një rast i mirë në rivendosjen e marrëdhënieve shumë të mira e të veçanta ndërmjet dy vendeve. Që më 5 shtator 1388, shohim se Gjergj II Strazimirin, autoritetet raguzane i kërkuan që të dërgonte në Raguzë një njeri të besuar që të merreshin vesh në lidhje me lëvizjen e ushtrive osmane.⁵⁸ Edhe pse, nuk kemi të dhëna të qarta se cilat ishin informatat që raguzanët i morën për lëvizjet e ushtrive osmane, megjithatë, mund të supozojmë se ky shërbim i Gjergjit II në të mirë të Raguzës ishte i dobishëm. Këtë konstatim mund ta mbështesim në faktin, se shumë shpejt do të shohim një afërsi të papritur të Gjergjit II me raguzanët. Në Senatin raguzan më 12 tetor të po këtij viti u paraqit ambasadori i Gjergj II Strazimirin, Çanin Barelli, i cili u prit me të gjitha nderimet që u rezervoheshin personaliteteve të larta. Me t'u kthyer në Ulqin, ai i paraqiti zotërisë së vet mirënjohjen e thellë që raguzanët kishin ndaj familjes Balsha, për nderet e pafundme që kishin gëzuar prej tyre deri atëherë. Republika e Shën Vlashit i ishte mirënjohës zotërisë së Zetës, për ndalimin e komandantit osman Shahinit, që ai të mos e sulmonte Raguzën në vitin 1388. Në shenjë mirënjohjeje ata i dhanë të drejtën më të lartë, atë të qytetarisë së Raguzës. Marrja e të drejtave të qytetarisë së Raguzës nga Gjergj II Strazimir Balsha u bë më 15 tetor të vitit 1388.⁵⁹ Qytetaria që senati i Raguzës i kishte dhënë Gjergjit II, për

⁵⁷ “Die XXVI augusti. Rogatorum ballota XV. Prima pars est de faciendo libere relaxari omnes Albanenses fugientes captos per nostros Ragusinos...quod non possint vendi Albanenses in ragusio vel district per alios”, HR-DADU, Reformationes, vol.XXVII (1386-1388), 87v-88r; G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi ...*, f. 168.

⁵⁸ HR-DADU, Reformationes, vol.XXVII (1386-1388), fol.88v.

⁵⁹ “Magnificus dominus d. Georgius filius q. Stracimerii de Balsa dominus Gente etc. per d. rectorem ser Nicolaum

de Gondula et suum Minus (sic) fuit acceptus et receptatus in honorabilem civem civitatis Ragusii, pro se et suis, infrascriptis conditionibus et pactis: primo, quod dictus magnificus dominus sit et esse debeat obligatus omnibus legibus, statutis, ordinibus tam factis quam fiendis in posterum ac consuetudinibus, honoribus et honoribus ac prerogativis quibus utuntur et sunt obligati alii cives Ragusia ... prefatus dominus et sui heredes possint et valeant venire Ragusium cum suis familiis, eorum bonis et rebus et eorum famulis et ibidem tute stare et immorari et inde discedere et reverti ad omne suum beneplacitum voluntatis et suorum heredum totiens quociens eis placuerit et venire, stare, redire et recedere voluerint, semper procurando et

merita të veçanta, ishte krejtësisht ndryshe nga e drejta e qytetarisë që u ishte dhënë disa tregtarëve ose zejtarëve të pasur. Nga qytetarët e saj të nderuar, në këtë rast edhe nga Gjergji II Strazimiri, qeveria priste mbështetje miqësore sa herë që ishte e nevojshme, dhe në këmbim, ajo siguroi strehim, si dhe shërbime të tjera. Me këtë akt, Gjergjit II dhe pasardhësve të tij iu dha mundësia për të qëndruar në qytet sa herë të dëshironte. Në rast rreziku që ai duhet të largohet nga Zeta, atij, gjithashtu iu dha në dispozicion, një shtëpi e pajisur me të gjitha komoditetet, me të drejtën për të qëndruar aty me shpenzimet e Raguzës.⁶⁰

Në të vërtetë, që nga mesi i shek.XIV, Raguzë në sajë të zhvillimit që kishte si republikë tregtare po përjetonte rritje ekonomike të dukshme. Si e tillë ajo u bë tërheqëse jo vetëm për qytetarët e rrezikuar në brendësi të saj, por edhe për njerëzit që donin të arrinin suksese. Në anën tjetër, qyteti i Kotorrit u prek më pas nga luftërat, ndryshimet e zotërinjve (Hungaria, Venediku, Bosnja), bllokadat dhe fatkeqësitë e brendshme. Për këto arsye, kotorrasit nuk i kishin në dorë aktivitetet tregtare, veprimtaria kryesore e të cilës ushtrohej nga raguzanët. Për shkak të kësaj, banorë të viseve të ndryshme të Shqipërisë dhe bregdetit të Zetës shkonin në Raguzë.⁶¹ Qytetarët nga Zeta dhe pjesët e tjera të Shqipërisë mesjetare, mund të fitonin shtetësinë e Raguzës nëse qëndronin për një kohë të caktuar. Në atë rast, ata duhej të kontribuonin për mirëqenien dhe prosperitetin e qytetit. Ata që dëshironin të fitonin qytetarinë, kishin një detyrim për të shkuar me familjen, për të blerë një pasuri të paluajtshme dhe t'i kryenin të gjitha detyrimet dhe obligimet si të gjithë qytetarët e tjerë.

Në bazë të dokumenteve të shumta të Këshillit të Vogël, gjejmë se këtë të drejtë e kishin fituar njerëz të biznesit të cilët vërehen se janë nga Zeta arbërore. Në periudhën 1385-1403, tri grupe të tregtarëve të

intendendo et vacando bono statui dicte civitatis Ragusii.”, HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXVIII (1388-1390), fol.4r-5r; G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi ...*, f. 168-169; I. Božić, *Dubrovnik i Turska...*, f. 9.

⁶⁰ G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi ...*, f. 169; Jovanka Mijušković, “Dodjeljivanje dubrovačkog građanstva u srednjem veku”, në *Glas SANU*, br.9, Beograd: 1961, f. 90-102; Zdenka Janeković-Römer, “Stranac u srednjovekovnom Dubrovniku: između prihvaćenosti i odbačenosti”, në *Radovi Zavoda za hrvatsku povijest*, vol.26, no.1, Zagreb: 1993, f. 29-34;

⁶¹ Sima Ćirković, “Dubrovnik i zaleđe u srednjem veku”, në *Rabotnici, vojnici, duhovnici: društva srednjovekovnog Balkana*, Beograd: Equilibrium, 1997, f. 50-51.

suksesshëm morën shtetësinë e Raguzës. Grupi i parë përbëhej nga tregtarët e pasur, të karakterizuar nga fakti se nuk kishin më shumë se një gjeneratë që jetonin dhe vepronin në Raguzë. Grupi i dytë përbëhej nga familje të pasura, disa prej të cilave dispononin me pasuritë. Ky grup tregtarësh ishte i angazhuar në punë tregtie dhe ishte i pranishëm në jetën shoqërore të Republikës përmes disa gjeneratave. Grupi i tretë u përfaqësua nga tregtarët e familjeve shumë të pasura që ishin pjesë e shoqatave dhe korporatave të tregtarëve të pasur, pronarëve të anijeve, financierëve/bankierëve, shërbyesve të respektuar publikë (mësues, mjekë dhe kancelarë). Nga grupi i parë që fituan qytetarinë ishin shumë qytetarë shqiptarë nga Drishti, Tivari, Ulqini, Shtoji, Rataci etj., si Pjetër Suma nga Drishti, Shtjefën Marini nga Ulqini, Niksha, Piero Cagn dhe Stano nga Tivari, anëtarë të familjes Tani nga Ulqini⁶² e shumë të tjerë.

Autoritetet e Raguzës, në saje të miqësisë që kishin me të, u munduan që Gjergji II t'i gjendeshin afër edhe në momentet e fundit të jetës. Që në dhjetor të vitit 1402 gjendja shëndetësore e tij ishte rënduar. Një dobësi për vdekje e kaploi dalëngadalë dhe në gjysmën e dytë të marsit të vitit 1403, Gjergj II Strazimir Balsha mbeti i shtrirë në shtrat. Kryegjakoni i Ulqinit⁶³ kërkoi ndihmën e mjekëve raguzanë (21 mars 1403), të cilët, si zakonisht, ia ofruan këtë shërbim menjëherë.⁶⁴ Por, gjendja e tij nuk jepte shpresë për jetë dhe mjekimet që iu bënë ishin të kota. Gjergji II Strazimir Balsha vdiq në gjysmën e parë të muajit prill të vitit 1403. Në Raguzë, ata u njoftuan për vdekjen e tij më 18 prill. Po në

⁶² Dušanka Dinić-Knežević, *Migracije stanovništva iz južnoslovenskih zemalja u Dubrovnik tokom srednjeg veka*, Novi Sad: SANU, Ogranak u Novom Sadu, Filozofski fakultet u Novom Sadu, Odsek za istoriju, 1995, f. 201; Zrinka Pešorda Vardić, *U predvorju vlasti. Dubrovački antunini u kasnom srednjem vijeku*, Zagreb-Dubrovnik: Zavod za povijesne znanosti HAZU u Dubrovniku i Hrvatski institut za povijest, 2012, f. 86-87; M. Premović, "Trgovački odnosi Zete"..., f. 889-890.

⁶³ HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXXII (1402-1404), fol.21r.

⁶⁴ Kujtojmë se një ndihmë e tillë ishte kërkuar edhe më parë: Balsha II kishte qenë i sëmurë plot një vit, por e kishte marrë veten plotësisht në fillim të vitit 1383. U sëmur, bashkë me të shoqen, përsëri në tetor dhe në nëntor të vitit 1383. Raguzanët, që ishin treguar gjithmonë të përzemërt me mikun e tyre të dashur, i dërguan mjekun e tyre. (G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi ...*, 237). Në janar të vitit 1390, Gjergji II Strazimir Balsha kishte probleme shëndetësore dhe për këtë i drejtua Raguzës me kërkesën që t'i dërgonte një mjek. Këshilli i Vogël i qytetit vendosi të dërgonte te ai mjekun Albertin. (Lonza & Šundrica, *Odluke 1390-1392...*, f. 103.)

të njëjtën ditë, Këshilli i Vogël nxori një udhëzim dhe përmes përfaqësuesve të saj, Nalko dhe Marin de Giorgi, të cilët u nisën për në Ulqin, i dërgoi një letër bashkëshortes së të ndjerit, Helenës. Të dërguarit e Republikës së Raguzës i shprehën në emër të raguzanëve ngushëllime të veçës me rastin e vdekjes së Gjergji II Strazimir Balshës, duke deklaruar se ai ishte i dashur për të gjithë njerëzit dhe fqinjët, dhe se raguzanët ishin ndier shumë keq për vdekjen e “*mikut të tyre të mirë dhe të veçantë*” (bono et speciale amico).⁶⁵

Nga përfaqësuesit e Raguzës, të cilët ishin për ngushëllime në Ulqin, mësojmë se çështja e doganave ishte aktuale edhe në vitin 1403. Kur ata shkuan më 18 prill në Ulqin, në atë rast, delegacionit iu dha mundësia për të kërkuar sqarime lidhur me çështjen e disa taksave që Gjergji II Strazimir Balsha sapo i kishte vendosur në Ulqin. Të dërguarit e Raguzës të Helena, i kujtuan asaj ekzistencën e atyre taksave, u ankuan për pasojat e tyre dhe i kërkuan që t’i hiqte sa më parë.⁶⁶

Në fund, mund të konkludojmë se me gjithë disa ndërprerje të vogla, marrëdhëniet midis Principatës së Balshajve dhe Raguzës në periudhën e qeverisjes së Gjergji II Strazimir Balshës u karakterizuan si marrëdhënie mjaft intensive dhe relativisht të mira. Afërsia e tyre territoriale dhe lidhjet tregtare kontribuan në zhvillimin e ndërsjellë ekonomik dhe ndikuan në ndërtimin gradual të marrëdhënieve politike. Në politikën e jashtme, autoritetet e Raguzës u udhëhoqën nga parimi i kërkimit të privilegjeve të vjetra kur fillonte veprimtarinë e tij një sundimtar i ri. Ata ishin të interesuar për stabilitetin e marrëdhënieve të ndërsjella me familjen Balsha dhe në vazhdimësinë e privilegjeve të fituara më parë,

⁶⁵ “...*rectore di Ragusa cum lo nostro minor consiglio cometemo a vui Nalcho et Marino di Giorgii nobili citadini nostri, che in lo nome di dio siando vui ziunti a Dulcigno ala presentia dela magnifica dompna madopna Helena, relictade de la bona memoria de misser Georgii di Stracimiro presentade ad ella la letera di credenca che portade cum vui, quella salutadi per parte del regimento et zintili homini de Ragusio, cum quello saludo parera ala vostra descripcione (!) convegnese et di poy seguiti como qui apreso se contene...a misser domene dio a clamare a sy la bona memoria de misser Gorgy signore vostro et nostro bono et speciale amico, dela morte del quale condole et rincesse, quante dire se po...*” HR-DADU, *Reformationes*, vol.XXXII (1402-1404), fol.34v; *Acta Albaniae II...*, nr.722; G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi ...*, 240.

⁶⁶ HR-DADU, *Lettere e commissioni di Levante*, vol. IV (1403-1410), fol.12r-v; Gelcich, *Zeta...*, f. 242-243.

kryesisht për të mbrojtur tregtinë e tyre. Rrugët kryesore tregtare kalonin përmes zotërimeve të Principatës së Balshajve në bregdet dhe më tej në pjesën kontinentale. Prandaj, Republika e Shën Vlashit lidhi me familjen Balsha një seri marrëveshjesh, të cilat rregulluan statusin ligjor të qytetarëve të saj.

Në anën tjetër, interesi i bashkëpunimit të Balshajve me Raguzën konsistonte në: trajtimin miqësor dhe përkrahjen e zotërisë së Principatës së Balshajve, Gjergjit II dhe familjes së tij; strehimin e familjes së tij kur i kërcënohej rreziku i ekspeditave të ushtrive osmane; në dhënien dhe riparimin e armatimeve; në dhënien e statusit të qytetarisë (më 1388); në sigurimin e mjekëve dhe kujdesit shëndetësor; në dhënien e huave; në ndihmën diplomatike; në kontributin e saj në ndërmjetësimin e konflikteve me zotërinë e Bosnjës, Tvërtkon I, me ata të Kotorrit, me familjen e Gjurashëve (Cërnojeviqëve), dhe të tjerët. Një vend të rëndësishëm në misionet diplomatike të Raguzës me Gjergjin II zunë dhuratat, të cilat, si një mesazh diplomatik ishin akt i komunikimit joverbal, dhe shprehnin respekt, besim dhe miqësi të ndërsjellë. Të gjitha këto kishin për qëllim jo vetëm marrëdhënie të mira fqinjësore në momente të caktuara, por përfitime konkrete dhe afatgjata tregtare dhe politike.

S u m m a r y

RELATIONSHIPS OF GJERGJ II STRAZIMIR BALSHA WITH REPUBLIC OF RAGUSA

Diplomatical and commercial relations between Gjergji II Strazimir Balsha (1385-1403), and Ragusa in the studied period were intense. The economic development of Ragusa in the last decade of the 14th and during the first years of the 15th century attracted residents from the towns of Zeta, while, when it comes to the foreign politics, the inhabitants of Ragusa were adhering to the principle that when a new ruler or the district governor comes, they would seek confirmation of old privileges. From the earlier contracts stemmed the obligations, which were accentuated in order to substantiate certain requirements, to justify certain actions or to enhance fortitude of established relations.

Several months after Gjergji II had seized power, the citizens of Ragusa sent envoys to obtain a confirmation of trade preferences and privileges, which had been granted to the town by his predecessors. The new ruler of Zeta issued a charter (diploma) on 27 January 1386 confirming friendship and the granted freedom of trade. Trade relations were not solely limited to goods and transit traffic, since the financial operations were present, as well. The people from Zeta often borrowed money in Ragusa, under precisely envisaged conditions.

The number of traders of Albania and Zeta gained trading success and wealth in business, and according to the stipulated conditions, they acquired Ragusa citizenship. Exactly, Gjergji II Strazimir Balsha was awarded honorary citizenship of Ragusa, on 15 October 1388, as a token of gratitude for his intervention with the ottoman army commander Shahin Beu at the moment of intended attack on the Republic of Ragusa. The political motive for granting Gjergj II citizenship was a sign of deep gratitude for his help in preventing the Ottoman attack on the city. Generally, the diplomatic activity of Ragusa was mainly directed at ensuring freedom and smooth development of trade.

Based on archival resources from the State Archive Dubrovnik and relevant literature we can safely conclude that, however, some minor misunderstandings occurred in 1396, 1397 and 1403, diplomatical and commercial relations between Gjergji II and Ragusa were generally good. These misunderstandings had, however, little effect on external political relations. Thanks to their skilled diplomacy, the citizens of Ragusa successfully eliminated the misunderstandings; the good will from the Zeta side acted in common interest as well. Both parties managed to create good relations by investing mutual effort in common interest.

All of these were meant not just good neighborly relations at certain moments, but concrete and long-term trade and political benefits.

